



Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), UA MPMS nr. 07/2017 dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01/2710/2021, datë 09.11.2021 dhe Vendimin e Bordit të Drejtorëve me numër 01-199-1/24 datë 24.01.2024 PK Sh.A. me datën 15.02.2024 shpall:

KONKURS I BRENDSEM PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

1. Auditor/e i/e Brendshëm/e (GRADA 10) 1 Ekzektues

Përshkrimi: PK Sh.A., është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës Nr. 01/2710/2021 datë 09.11.2021, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

Pozita e punës : Auditor/e i/e Brendshëm/e Vendi i punës : Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale dhe ruan certifikimin e vet profesional, duke marrë pjesë në 60 orë trajnim brenda dy viteve të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara të Ligjit nr. 06/L-021;
- Përgatit planin për njësinë (departamentin) për auditim;
- Siguron cilësi të angazhimeve të auditimit;
- Përgatit letra të punës në lidhje me auditimin e kryer;
- Përpilon dhe përgatit nivelin e rreziqeve, të cilat duhet t'i kryejë gjatë auditimit;
- Jep rekomandime adekuate për njësinë/departamentin e audituar;
- Kryen auditim të rregullsisë financiare, operative, ligjore, performancës, përcjelljes, etj;
- Zbaton detyrat dhe përgjegjësitë sipas plan-programit dhe kërkesave shtesë, të cilat mund të delegohen nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm i NJAB [ZAB];
- Përgatit dhe adapton pyetësorët sipas aktivitetit auditues;
- Nxjerr mostra sipas gjykimit profesional ose metodave tjera relevante;
- Mbledh dhe analizon të dhënat;
- Mban takimin përmbyllës të auditimit;
- Përgatit draft-raportin dhe raportin përfundimtar të auditimit;
- Përgatit raporte të qarta dhe koncize të auditimit;
- Përcjell implementimin e rekomandimeve të dhëna;

- Verifikon rregullisht përshtatshmërinë që ka për qëllim që të sigurojë se dokumentacioni financiar, ligjor mbahet në përputhje me standardet, rregullat dhe ligjet përkatëse;
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave, të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë;
- Raporton për aktivitetet audituese tek ZAB;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga ZAB.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

- Të ketë diplomë universitare në ekonomi, financa, kontabilitet, administratë publike, juridik apo të ngjashme;
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit ose kontabilitetit, menaxhimit financiar;
- Të jetë auditor i brendshëm i certifikuar sipas nenit 22 pika 2.2 të Ligjit nr. 06/L-021, njohës i mirë i sistemit financiar, kontabël;
- Të zhvillojë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, si dhe të ruajë certifikimin sipas nenit 25 pika 1.3 të Ligjit nr. 06/L-021;
- Të ketë njohuri nga fusha e qeverisjes korporative dhe financiare;
- Të ketë njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme për analizim dhe definim të problemeve, fakteve dhe për dhënie të rekomandimeve dhe konkluzioneve të bazuara në dëshmi;
- Të demonstrojë aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me Menaxhmentin dhe stafin e ndërmarrjes;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint).

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e PK-së <https://postakosoves.com/publikime/mundesi-punesimi/>);
2. Deklaratën nën betim (e cila shkarkohet nga web -faqja e PK-së <https://postakosoves.com/ep-content/uploads/2021/09/Deklarata-ne%CC%88n-betim.-pdf.pdf>)
3. CV-ja (Biografia),
4. Diplomat mbi shkollimin (diplomat e fituara jashtë Republikës Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara sipas Ligjit);
5. Dëshmi mbi përvojën e punës, së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit ose kontabilitetit, menaxhimit financiar;
6. Certifikata e auditorit/es të brendshëm
7. Dëshminë mbi ruajtjen e certifikimin sipas nenit 25 pika 1.3 të Ligjit nr. 06/L-021;
6. Dëshmi nga Gjykata kompetente që ndaj kandidatit në fjalë nuk është duke u zhvilluar procedurë penale, jo më të vjetër se 6 muaj (Origjinali).

Mënyra e Aplikimi: Aplikacionet mund të merren online www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen në e-mail adresën : hr.konkursi@postakosoves.com .Në përshkrim të ceket titulli i pozitës për të cilën konkurroni.

Aplikacionet e pakompletuara plotësisht nuk do të merren parasysh.

Aplikacionet të cilat dorëzohen pas afatit nuk do shqyrtohen.

-Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Konkursi është i hapur nga data 15.02.2024 dhe përfundon më datë 01.03.2024 në ora 16:00

Kandidatët që i plotësojnë kushtet fillimisht do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe vetëm ata kandidatë, të cilët do të kalojnë testin, do të hyjnë në rrethin e ngushtë dhe do t'i nënshtrohen intervistës.

Nora Rraci

Kryeshef Ekzekutiv – Posta e Kosovës Sh.A.

